

VENDIM
Nr. 145, datë 20.2.2013

**PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
ME PËRFAQËSUES NË SHTABIN “EUFOR”, NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK
“ALTHEA”, TË BASHKIMIT EUROPIAN,
NË BOSNJË-HERCEGOVINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 pika 5, e 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të 1 (një) përfaqësuesi ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, në shtabin “EUFOR”, në kuadër të operacionit ushtarak “ALTHEA”, të Bashkimit Europian.

2. Misioni i përfaqësuesit ushtarak, në kuadër të operacionit ushtarak “ALTHEA”, është drejtimi, monitorimi, këshillimi i Forcave të Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës për të gjitha çështjet në lidhje me stërvitjen kolektive, me qëllim implementimin dhe arritjen e aftësive mbrojtëse.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 2 (dy) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të përfaqësuesit të parë ushtarak në Bosnjë-Hercegovinë. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.

4. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për përfaqësuesin ushtarak pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shërbimin telefonik dhe internet;

dh) transport;

e) transportimin e individit të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje ose sëmundjeje;

ë) akomodim (fjetje, ngrohje, ujë);

f) ushqim;

g) energji elektrike, ujë të pijshëm, lavanderi;

gj) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kryerjes së misionit;

h) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

5. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i cili do të marrë pjesë në këtë mision.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha